




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-662/14
Dep. 2-D/DPK	Br Prot. 01-662/14
Nr. i faq. 02	Data 24.02.2014
Broj stranica 02	Datum 24.02.2014
Nr. pages 02	Date 24.02.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24/02/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gzim SHALA Shef i Prokurimit – Spitali Rajonal - Ferizaj
CC:	z. Bahri GOGA u.d. Drejtor i Qendrës për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik - Psikiatrik - Shtime
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “Ofrimi i shërbimeve për Mirëmbajtjen Higjeniko Sanitare të ambientit dhe hapësirave të brendshme të QIRSKP–Shtime“



I nderuar z.SHALA,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Ofrimi i shërbimeve për Mirëmbajtjen Higjeniko Sanitare të ambientit dhe hapësirave të brendshme të QIRSKP–Shtime“ me nr. të prokurimit: 712-2014-009-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Ofrimi i shërbimeve për Mirëmbajtjen Higjeniko Sanitare të ambientit dhe hapësirave të brendshme të QIRSKP–Shtime“ në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik - Psikiatrik – Shtime, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Ofrimi i shërbimeve për Mirëmbajtjen Higjieniko Sanitare të ambientit dhe hapësirave të brendshme të QIRSKP–Shtime” me nr. të prokurimit: 712-2014-009-221. Ky aktivitet prokurimi më datë 11/02/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 7.2, kërkohet: Qarkullimin financiar në tri vitet e fundit prej (2011,2012,dhe 2013) për shërbime të ngjashme së paku 500.000,00 €(obligativ). Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkoj qarkullim financiar më tepër se dyfishi i vlerës së parashikuar, si vlerë minimale. Përveç qarkullimit minimal, Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj edhe referenca në fushën specifike, por shuma e tyre nuk mund të kaloj më shume se 1.5 herë vlerën e parashikuar. Gjatë përcaktimit të kërkesave për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të operatorëve ekonomik të rinj dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të rinj të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme mundësitë ekonomike, financiare dhe/ose teknike

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Neni 5, Gjendja ekonomike dhe Financiare e udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së, si dhe Neni 8 Kriteret e Përzgjedhjes i Rregullores për Prokurim Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për shërbyesit ose shërbyesit potencial. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një shërbyes të caktuar ose shërbyes potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!